



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr 1444 / 2021

Në bazë të Rregullorës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 01/ 5349/ 2020 të datës 31.08.2020 neni 14 pika 14.1.1 dhe neni 15 ,dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.01/186/2021 të datës 28.01.2021 për ndarjen e mjeteve financiar për bursa për studentët e Komunës së Hanit të Elezit, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport shpallë:

KONKURS
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Kushtet për aplikim:

- a) Të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit;
- b) Të jenë student/e të Universitetit Publik të Kosovës;
- c) Të jenë student/e të rregullt, por jo me vet financim;
- d) Të kenë regjistruar vitin;
- e) Studenti/ja nëse një herë ka përsëritur vitin, humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet);
- f) Studenti/ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë;
- g) Studenti/ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë;
- h) Prioritetet për kuadro deficitare janë Fakultetet:

-Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji);

-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;

-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike ,Elektroenergjetikë Industriale);

-Fakulteti i Inxhinieris Mekanike (Prodhimatarit dhe Automatizëm, Termoenergjetikë dhe Termoteknikë, Konstruksiione dhe mekanizim, Komunikacion);

-Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zooteknik, Lavërtari-Perimatarit, Mbrotjtje e Bimëve, Pemëtarit-Vrëshatarit, Veterinarit, Bioteknologji Ushqimore);

-Fakulteti i Xehtarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë);

-Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore (Matematikë, Fizikë, Kimi);

-Fakulteti i Arteve;

-Fakulteti Filologjik (Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane);

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- a) Çertifikata e notave (me vulë origjinale);
- b) Vërtetimi i semestrit se studenti ka regjistruar vitin akademik 2020/2021 (me vulë origjinale);
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat);
- d) Deklarata e bashkësisë familjare;
- e) Çertifikatën e vendbanimit;
- f) Dëshmia se është; invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale;

- g) Studentë që janë invalid të luftës, anëtarë të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirët e luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat libreza dhe institucionet përkatëse;
- h) Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit;
- i) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës;
- j) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- k) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale);

Afati dhe menyra e aplikimit;

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit (kati i parë) nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.

Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej **datës 02.03.2021** deri më datën **16.03.2021**

Sqarim shtesë: Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores Nr. 01/ 5349/ 2020 do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

Vërejtje: Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.



Drejtori i DKAIRS-së
Menduh Vlasi